



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
NJËSIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT TË KONTRATËS KONCESIONARE/PPP
“PËR PËRMIRËSIMIN, NDËRTIMIN, OPERIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E
RRUGËS SË ARBRIT”

Nr. 425 prot.

Tiranë, më 11/01/2019

Lënda: Mbi punimet e kryera, të faturuara nga shoqëria koncesionare “GJOKA 87” sh.p.k., në zbatim të Kontratës së Koncesionit/PPP, “Për Përmirësimin, Ndërtimin, Operimin dhe Mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit”, nën 27, pika 27.1.4.

DREJTORISË SË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Këtu ✓

Për dajeni: AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR
Drejtoria e Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes
Sektorit të Partneritetit Publik Privat
Rr. “Sami Frashëri”, Tiranë.

Referuar Kontratës së Koncesionit/PPP, “Për Përmirësimin, Ndërtimin, Operimin dhe Mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit”, miratuar me VKM nr. 180, datë 28.03.2018, në nenin 27 “Pagesa”, pika 27.1.4 përcaktohet “Pagesat nga Autoriteti Kontraktor kundrejt Koncesionarit, do të fillojnë, pasi Koncesionari të këtë kryer 25% të volumit të punimeve të parashikuara në grafikun e punimeve (pjesë e Projektzbatimit).

Pavarësisht përcaktimit në paragrafin e mësipërm, Koncesionari do të paguhet për punimet e kryera në fund të vitit të parë (pasi kontrata të jetë bërë efektive) vetëm nëse ka kryer mbi 20% të volumit të parashikuar të punimeve. Kjo pagesë do të behet në raport me përfundjen e votimeve të këtyre punimeve të parashikuara në grafikun e punimeve. [...]”.

Ndërsa në pikën 27.1.5 përcaktohet “Gjatë periudhës së përmirësimit dhe ndërtimit të Rrugës deri në përfundim të saj, Koncesionari do të hartojë situacionet mujore të ndërtimit dhe faturën tatimore mujore përkatëse, të cilat konfirmohen/miratohet nga Inxhinieri i Pavarur. Situacioni mujor dhe fatura tatimore përkatëse hartohen në Lekë dhe i dorëzohen Autoritetit Kontraktor, i cili do të paguajë sipas përcaktimit të nenit 27.1.3. [...]”.

[REDACTED] në cilësinë e Inxhinierit të Pavarur të Përkohshëm për kontratën koncesionare/ppp të sipërcituar, me monitorimin e punimeve në zbatim të grafikut të punimeve dhe kontrollit e korigjimevë të nevojshme, ka miratuar/certifikuar punimet e kryera sipas situacioneve pjesore të dorëzuara, deri në momentin e përfundimit të procedurave të përzgjedhjes së Inxhinierit të Pavarur. Konkretish IPP me anë të shkresës:

- Nr. 14/1, datë 04.09.2018, ka konfirmuar Situacionin nr. 1 (Situacioni pjesor i Punimeve); (Fatura Tatimore me nr. serie 63302505; fatura nr. 5, datë 31.07.2018 me vlerë totale 1,649,502,240 lekë me TVSH)
- Nr. 14/4, datë 08.10.2018, ka konfirmuar Situacionin nr. 2 (Situacioni pjesor i Punimeve); (Fatura Tatimore me nr. serie 63302506; fatura nr. 6, datë 31.08.2018 me vlerë totale 898,196,451 lekë me TVSH)
- Nr. 24/1, datë 29.10.2018, ka konfirmuar Situacionin nr. 3 (Situacioni pjesor i Punimeve); (Fatura Tatimore me nr. serie 63302507; fatura nr. 7, datë 30.09.2018 me vlerë totale 1,200,357,114 lekë me TVSH)
- Nr. 29/1, datë 12.11.2018, ka konfirmuar Situacionin nr. 4 (Situacioni pjesor i Punimeve); (Fatura Tatimore me nr. serie 63302508; fatura nr. 8, datë 31.10.2018 me vlerë totale 1,464,678,941 lekë me TVSH)

Në përfundimi të procedurave të përzgjedhjes së Inxhinierit të Pavarur, në datën 09.11.2018 u lidh Kontrata e Shërbimit me nr. 10959/15 prot. midis MIE dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive "GR ALBANIA" sh.p.k. & "GAUFF GmbH & Co Engineering", përfaqësuar nga "GR ALBANIA" sh.p.k. IP i përzgjedhur, me monitorimin e punimeve në zbatim të grafikut të punimeve dhe kontrollit përkatës, ka miratuar/certifikuar punimet e kryera sipas situacionit pjesor nr. 5 (Situacioni pjesor i Punimeve), dorëzuar me anë të shkresës nr. 2018/07 prot., datë 28.12.2018;

(Fatura Tatimore me nr. serie 63302509; fatura nr. 9, datë 30.11.2018 me vlerë totale 1,729,272,308.9 lekë me TVSH)

Sa më sipër, Njësia e Zbatimit të Projektit të kontratës koncesionare/ppp, "Për Përmirësimin, Ndërtimin, Operimin dhe Mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit", po ju përcjell edhe situacionet pjesore nr. 3, nr. 4 dhe nr. 5, sipas dokumentave origjinale bashkëlidhur.

Akoma më tej, Inxhinieri i Pavarur BOE "GR ALBANIA" sh.p.k. & "GAUFF GmbH & Co Engineering", përfaqësuar nga "GR ALBANIA" sh.p.k., me anë të shkresës protokolluar pranë MIE me nr. 15472/2 prot., datë 28.12.2018, ka konfirmuar plotësimin e kushteve të përcaktuara në nenin 27, pika 27.1.4 të kontratës koncesionare/ppp "Për Përmirësimin, Ndërtimin, Operimin dhe Mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit", duke u shprehur se "... gjatë monitorimit të punimeve në zbatim të grafikut të punimeve dhe kontrollit të votimeve periodike të realizuara nga shoqëria koncesionare "GJOKA 87" sh.p.k., verifikuan të gjitha punimet e situacionuara deri më tani në situacionet e dorëzuara. Mbështetur në verifikimin dhe monitorimin tonë konfirmojmë se në punimet e realizuara është kapërcyer masa 25% e volumit të punimeve sipas parashikimit në grafikun e punimeve/pjesë e Projektzbatimit." (bashkëlidhur shkresa)

Mbështetur në nenin 27 "Pagesa", pika 27.1.3, të kontratës së koncesionit/ppp, "Per Përmirësimin, Ndërtimin, Operimin dhe Mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrës", miratuar me VKM nr. 180, datë 28.03.2018, si dhe konfirmimit të IP me shikresë nr. 15472/2 prot., datë 28.12.2018, lutemi të procedohet me likuidimet financiare sipas Modelit Financiar të rënë dakord mes palëve.

Faleminderit për bashkëpunimin.

Njësia e Zbatimit të Projektit:

